



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, pika "b" të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par. 1, pika "b" të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2007, merr

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VËNDOSJEN E**  
**TRAFOSTACIONIT 10/ KV**

**Neni 1**

Caktohet lokacioni për vendosjen e trafostacionit në një pjesë të të ngastrës kadastrore nr. 7090/1, të evidencuar në fletën poseduese nr. 4137 (pronë e Komunës së Prishtinës), Zona kadastrore Prishtinë.

Ngastra e lartcekur përfshinë një sipërfaqe prej 13.12.67 ha, ku për nevojat e vendosjes së këtij objekti shfrytëzohen 10m<sup>2</sup>.

**Neni 2**

Rregullimin urbanistik të bazës së lokacionit të caktuar sipas nenit 1 të këtij Vendimi, do ta kryejë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë.

**Neni 3**

Realizimi i këtij Vendimi do të bëhet në tërësi sipas kushteve urbanistiko-teknike, të cilat duhet përgatitur Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01. Nr.353-131, më 29.03.2007**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**